MENDO MIRË PËR ZOTIN TËND, LËRI NJERËZIT NË BOTËN E TYRE!

INTERVISTË ME DR. SALAHUDIN KEFTARO, MENDIMTARI I SHQUAR ISLAM

HZ. MUHAMMEDI (A.S), SHEMBULLI I NJË GJYSHI TË PËRKRYER

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 19 - Nr. 10 (224), Tetor, 2021

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990



Lindja e Begatë e Hz. Muhammedit (a.s)

Është dita e bekuar e përgjigjes së lutjes së Hz. Ibrahimit (a.s) dhe e realizimit të sihariqit të madh të Hz. Isait (a.s)!

"Mirë se vjen, Resul i pritun.
Mirë se vjen per boten mbarë
Zoti Te ka porositun,
Ta udh-heqish pa e ndarë."

"Mirë se vjen Mëshira e Zotit,
Mirë se vjen Nuri i Tí,
Ti je Shpresa e kohmotit,
Vetëm Ti je, vetëm Ti!.."

Ti je vete lumtenija,
Per gjith boten Myslimane,
Mos harro, se shqiptarija,
Te kanë babë e Te kan' nane.

(Hysni Bushati - 1932)

MYFTIU: "FAMILJA E SOTME TË KTHEHET NGA DRITA E RESULULLAHUT!"

Ditën e shtunë, më 30 tetor 2021, në xhaminë e fshatit Trush u zhvillua ceremonia tradicionale e Mevludit Sherifë, në kuadër të aktiviteteve të larmishme në përkujtim të Lindjes së Begatë të Resulullahut (a.s) dhe mesazhit me të cilin u dërgua si mëshirë për mbarë botët.

Aktiviteti nisi me leximin e një pjese kuranore nga H. Ervis Molla, imam i xhamisë Barbullush.

Më pas, ligjëroi Myftiu i Zonës Shkodër...

(f. 19)

TAKIM VLERASH ME STUDIUESIN E SHQUAR XHEMAL BALLA

Paraditën e së shtunës, më 23 tetor 2021, në kuadër të ciklit të trajnimeve që organizon Myftinia Shkodër me imamët e saj, u zhvillua edhe takimi i 9-të, ku i ftuar ishte studiuesi i shquar nga Tirana, prof. Xhemal Balla.

Në krye të herës, teologu Lavdrim Hamja theksoi se i ftuari i sotëm është një ndër emrat më të spikatur të këtyre 30 viteve, që ka dhënë një kontribut të madh për bashkësinë muslimane shqiptare, nëpërmjet drejtimit ...

(f. 17)

MESAZH ME RASTIN E MEVLUDIT SHERIFË 1443/2021

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të dashur besimtarë, motra dhe vëllezër!

Ditën e hënë, më 12 rebiulevel 1443, që përkon me datën 18 tetor 2021, mbarë bota islame përkujton momentin e bekuar të Lindjes së Begatë të Hz. Muhamedit (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të)!

Është pa dyshim dita më e gëzuar e krejt historisë së njerëzimit!

Është dita e bekuar e përgjigjes së lutjes së Hz. Ibrahimit (a.s) dhe e realizimit të sihariqit të madh të Hz. Isait (a.s)!

Është dita, kur në këtë botë erdh ai, që do të dërgohej nga Zoti i gjithësisë si: "mëshirë për mbarë botët"!

Është dita e ripërtëritjes së gëzimit të madh të lindjes së shpëtimtarit, pajtimtarit, mëshirës së dhuruar, ripërtëritësit të famës dhe madhështisë së vëllezërve të tij të dërguar ndër shekuj dhe plotësuesit deri në vulosje të Mesazhit të shenjtë hyjnor për mbarë botët!

Prandaj le të gëzojmë e ta përhapim kudo mesazhin e madh, që na fton të rikthehemi tek llogaritë tona me emrin dhe traditat e Hz. Muhamedit (a.s)!

Le ta pyesë secili veten e tij se si i ka marrëdhëniet me besimin, faljen e tolerimin, drejtësinë, ndershmërinë, pastërtinë, bamirësinë, dashurinë për tjetrin kushdo qoftë ai, dashurinë për atdheun dhe tokën e tij, për të afërmit, farefisin, si i ka marrëdhëniet me prindin, me familjen e fëmijët, si e vlerëson kohën, si sillet me vartësit e tij, si e trajton përgjegjësinë e zanatit, ku qëndron me besën, fjalën dhe ruajtjen e amanetit, si sillet me natyrën dhe kafshët, sa angazhohet për të ndihmuar nevojtarin, si sillet me jetimin dhe udhëtarin në nevojë, a i qan zemra për emigrantët e pambështetur e të braktisur në det, në të ftohtë, në kufij të përbuzur, shkeve të fjetur pa ngrënë e pa ujë?

Le ta pyesë secili veten se sa ka bërë për vendin e tij, për shoqërinë e tij, për njerëzimin, në drejtim të arsimimit të fëmijëve, edukimit me moral të lartë, me normat e qytetarisë, me vlerat e humanizmit, me dritën e dijes dhe zhvillimit, me dëshirën e natyrshme për të ruajtur ekuilibrat e paqes sociale dhe për ta mbrojtur atë si vlerë mbi vlerat, për të ndërtuar ura komunikimi dhe hapësira dialogu në realitetet e diversitetit e përtej tij!

Le ta pyesë secili veten se sa ka bërë për ambientin dhe natyrën, sa pemë e lule ka mbjellë përgjatë një viti, sa ujë ka kursyer, sa i kujdesshëm ka qenë me ushqimin dhe mosabuzimin me mirësitë e Zotit, me të cilat është rrethuar, sa falënderues ka qenë për ajrin e pastër dhe sa mirënjohës për shiun, sa mbrojtës i natyrës nga zjarret dhe sa i kujdesshëm ndaj pastërtisë së lumenjve dhe burimeve përreth tij?

Të gjitha këto dhe përtej tyre, i gjejmë të trupëzuara në mësimet dhe misionin e përbotshëm të Hz. Muhamedit (paqja qoftë mbi të), të cilin jemi të ftuar ta ndjekim e ta pasojmë, të shkojmë pas dritës së tij dhe të gëzohemi me këtë mirësi të madhe, përkujtimi i së cilës ripërtërihet vit pas viti si një mundësi e madhe për të ribërë llogaritë tona me veten, me besimin, me dashninë e njerzillekun tonë!

Me zemër të mirë këtë ditë dhe çdo ditë në të cilën ne sillemi me zemër e shpirt nga drita e Zotit, nga shembulli i përkryer i të dërguarit të Tij, nga traditat e fisnikërisë dhe moralit, përparimit dhe zhvillimit, që ai nxiti, dashurisë për njeriun, kushdo qoftë ai, dëshirës për të përhapur të mirën dhe poaq për të ndaluar të keqen në jetë, vullnetin për të jetuar në paqe me këdo dhe entuziazmin për të përhapur kudo e me këdo mëshirë dhe mirësi!

"Mirë se vjen, Resul i pritun.
Mirë se vjen per boten mbarë
Zoti Te ka porositun,
Ta udh-heqish pa e ndarë."

"Mirë se vjen Mëshira e Zotit,
Mirë se vjen Nuri i Tí,
Ti je Shpresa e kohmotit,
Vetëm Ti je, vetëm Ti!.."

Ti je vete lumtenija,
Per gjith boten Myslimane,
Mos harro, se shqiptarija,
Te kanë babë e Te kan' nane.

(HYSNI BUSHATI)

Shkodër, 17 tetor 2021

MENDO MIRË PËR ZOTIN TËND, LËRI NJERËZIT NË BOTËN E TYRE!

Problemet e trazimet me të cilat përballemi e kalojmë ditë pas dite, në momente të caktuara na lodhin, na prishin ditën, gati-gati na transformojnë, a na bëjnë të zymtë si qiell me re gri.

Në momente dilemash e ngecjesh në një pikë ku ndërthurren rrugët, shpesh njeriu vrapon të gjejë ngushëllim e të mbështetet tek dikush i besueshëm, i afërt, ndryshe nga të tjerët. Mundohet të heqë sadopak nga barra që ka mbi supe, të këshillohet, të dritësohet, të gjejë pak qetësi e dritë në fund të një tuneli, që duket se është më i gjatë se errësira e natës pa hënë..!?

Dhe kështu, situatat nëpër të cilat kalojmë, na risjellin në hatër nevojën që kemi për dikë në momente të caktuara, por...

Këto mendime më kujtuan një mikun tim damasken dhe urimin e tij të natyrshëm në një ditë xhumaje.

Urimi i mikut tim ishte shumë special. Përbëhej nga disa copëza urtësie dhe optimizmi, që do t'i ndaj edhe me ju, me shumë kënaqësi, në kontekstet e këtij meditime, me të cilin do të mbyll edhe këtë cikël shënimesh të heshtura, mbi të bardhë.

1.

I thanë një beduini: Do të vdesësh një ditë!

Tha: Dhe ku do të shkoj?

I thanë: Tek Allahu i Madhëruar!

Tha: Zatën, nuk kemi parë mirë, veçse nga Allahu! A të frikësohemi nga takimi i Tij?!

2.

U pyet një prej dijetarëve të shkuar: A njeh dikë që i pranohet lutja?

Tha: Jo, por njoh Atë që i përgjigjet lutjeve..!

3.

Një person e pyeti Ibn Abasin, sahabiun e nderuar: Kush do t'i llogarisë njerëzit në ditën e gjykimit?

Tha: Allahu!

Pyetësi thirri me të madhe: Shpëtuam, pasha Zotin e Qabes!

4.

Një i ri u sëmur rëndë dhe, në prag të vdekjes së tij, e ëma nisi të qante.

I tha: O nënë, nëse do ta linin ty në dorë të ma bëje llogarinë, çfarë do bëje me mua?

E ëma, tha: Do të mëshiroja!

I biri ia ktheu: Allahu është më i mëshirshëm me mua, sesa ti, nëna ime!

5.

Duke na treguar një nga momentet e ditës së gjykimit, Allahu i Madhëruar urdhëron në Kuran: "... e para të Gjithmëshirshmit do të ulen zërat..." - (Kurani, TaHa: 103).

Nuk ka thënë: "Para Fuqiplotit", edhe pse ajo është një ditë e madhe dhe me dëshmi të shumta. Ka thënë: "para të Gjithëmëshirshmit", duke na dëshmuar mëshirë e shpresë edhe në atë moment, kur krejt zemrat do të dridhen!

Morali i këtyre rreshtave: Mendo mirë për Allahun, mos e humb shpresën në mbështetjen e Tij, vepro më të mirën nga vetja jote në kërkim të dashnisë dhe mëshirës së Tij dhe, përtej krejt situatave: "Mos u bështet në një mur që bie, as në një të gjallë të vdekshëm! Mbështetu tek i Gjalli që nuk vdes kurrë, prej Tij nuk do të zhgënjehesh asnjëherë!".

Mendo për pak lutjen e Hz. Zekerijasë (paqja qoftë mbi të): "... me lutjen time ndaj Teje o Zoti im, asnjëherë nuk kam qenë i dëshpëruar" - (Kurani, Merjem: 4) dhe lëre botën në botën e saj...

Imam Muhamed Bardhyl Sytari
Shkodër, më 21 tetor 2021

Dr. Mustafa Mahmud
(1921 - 2009)

"Ky është Muhammedi, Profeti, në të cilin janë bashkuar tiparet e plota, ku secila prej tyre ka arritur kulmin.

Ai është adhuruesi i përgjëruar, i cili është tretur në përkushtim dhe është shkrirë në dashuri.

Ai ishte luftëtari trim, i cili qëndronte në ballë të taborëve të vdekjes i palëkundur, ndërkohë mijëra trima të tjerë dhe kalorës arratiseshin përpara tij si burracakë.

Ai ishte projektuesi gjenial, i cili vizatonte projektet dhe ua shpërndante profesionisteve.

Ai ishte politikani i mprehtë, i cili lëvizte turmat dhe i mbërthente ato me litarët e ndjenjave me aftësinë e maestros dhe të novatorit.

Ai ishte oratori, i cili fliste me fjalët më të bukura.

Ai ishte babai, bashkëshorti dhe miku; ai ishte Thirrësi, i cili krijonte sistemin dhe ndërtonte shtetin prej hiçit: prej fiseve dhe individëve të përçarë, që nuk njihnin, veçse plaçkitjen rrugëve, hakmarrjen, mburrjen me prejardhjen dhe farefisin!

Ai ishte berzahu i sekreteve, zbuluesi i universit, i cili dëgjonte Allahun dhe melekët e Tij, ashtu siç dëgjojmë ne njëri-tjetrin, duke arritur me këtë majën e dijeve të dukshme dhe dijeve të padukshme së bashku dhe në të njëjtën kohë.

Ai ishte bujari, i durueshmi, i dhembshuri, i buti, i përmbajturi, i buzëqeshuri, i mëshirshmi, të cilin, përgjegjësitë e rënda, nuk e pengonin të luante me fëmijët dhe të vegjlit, e i mbante mbi supe, ndërkohë që përkulej, binte në sexhde dhe ngrihej në këmbë..!"

FJALA E MYFTIUT TË SHKODRËS NË CEREMONINË E PROMOVIMIT TË 10 HAFIZËVE TË RINJ

Ditën e shtunë, më 2 tetor 2021, Shoqata "Istanbul" organizoi ceremoninë e dytë për diplomimit e hafizëve të Qendrës për Memorizimin e Kuranit Famëlartë në Shkodër.

Në një atmosferërë shpirtërore dhe plot gëzim, u organizua ceremonia e dytë për diplomimin e hafizëve të Qendrës për Memorizimin e Kuranit Famëlartë në Shkodër, cila administrohet nga shoqata "Istanbul në Shkodër me mbështetjen e fondacionit Hudayi në Stamboll.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili mbajti edhe një fjalë, nëpërmjet të cilës iu drejtua të pranishëmve me këto fjalë:

*** *** ***

I nderuar z. Kujtim Dervishi, Drejtor i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia",

I nderuar z. Ridvan Seferaj, Kryetar i Shoqatës "Istanbul",

Të nderuar miq e të ftuar nga Republika e Turqisë,

Hafizë të dashur dhe ju të shtrenjtë prindër të pranishëm,

Tubimi i kësaj dite ka një simbolikë të veçantë për faktin se po promovojmë përfundimin e ciklit të plotë të mësimit përmendsh të Kuranit Famëlartë nga 10 djem të rinj, nga 10 shembuj për t'u ndjekur e modele për t'u krenuar me ta, sot e deri sa të kemi frymë!

Patjetër që duhet të falënderojmë me të madhe mësuesit edukatorë, kujdestarët dhe mbështetësit e këtij projekti dituror e qytetërues, në krye të cilëve qëndron Hoxha i urtë Osman ef. Nuri Topbash; projekt që e begaton qytetin e Shkodrës me ripërtëritjen e një tradite të vjetër, që lidh bijtë e kësaj toke me dashninë dhe përkushtimin ndaj Fjalës së Allahut të Madhëruar dhe i bën ata dhe fëmijët tanë që i janë përgjigjur kësaj ftese të brendshme në kufijtë e të shenjtës, pjesë e dëshmisë së madhe hyjnore: "Ata që e lexojnë librin e Allahut, e falin namazin dhe nga begatitë që Ne u kemi dhënë japin fshehtazi e haptazi, ata shpresojnë në një tregëti që kurrë nuk humbet".

Në hadithin e transmetuar nga Ibn Abasi (r.a), një person e pyeti të Dërguarin e Allahut, se cila ishte vepra më e pëlqyer tek Allahu. Ai, ndër të tjera i tha: "... Ta nisësh leximin e Kuranit nga fillimi. Sa herë që ta përfundosh, ta nisësh sërish nga fillimi", duke nxitur traditën e Hatmes Sherife (leximin e plotë të Kur'anit në mënyrë të vazhdueshme), mësimin dhe përvetësimin e Kuranit në jetën tonë.

Resulullahu (a.s) lajmëroi se: "Me të vërtetë Allahu ka të dashur e të përzgjedhur në mesin e njerëzve" Dhe kur e pyetën se kush janë ata, o i dërguar i Allahut? Ai tha: "Njerëzit e Kuranit, janë të dashurit e Allahut dhe njerëzit e Tij të afërt!"

Të dashur Hafizë, të shtrenjtë prindër!

Fjalën time do ta mbyll me një ngjarje të mrekullueshme që e kam shumë për zemrë dhe, sa herë i rikthehem, mbushem me shpresë e butësi, më kaplon mëshira dhe e ndjej veten të përkëdhelur para duarve të Zotit tim, që e lartësoi gradën e atyre që i përkushtohen Fjalës së Tij, sa asnjë gradë!

Një nga dijetarët më të shquar të Kuranit në mesin e shekullit të dytë hixhri, Hamza ibn Habib Ez-Zejati, për të cilin mësuesi i tij, djetari i shquar El-Amesh (61-148), kur e shihte të vinte, thoshte: "Ky është dijetari i Kuranit", ka një rrëfim të mrekullueshm të një përjetimi personal, që na lidh me dashninë e Allahut ndaj ehli-Kuranit!

Rrëfen Kalef ibn Bezari, nga mësuesi i tij Sulejm ibn Isa, nxënës i Hamza Zejatit (v. 156 h.): Hyra një ditë tek Hamza ibn Habib Zejati dhe e gjeta duke qarë, ndërkohë që ishte ulur në tokë, për të cilën fërkonte fytyrën e tij. Thashë: "Allahu të ruajtë!".

Tha: "Dhe pse po e thua këtë?!

Mbrëmë pashë në ëndërr sikur ishte bërë kijameti dhe u thirrën "kurraul-Kuran" (mësuesit dhe lexuesit e Kuranit) dhe unë isha në mesin e tyre. Dëgjova një zë të ëmbël që tha: "Mos të hyjnë tek Unë vetëm se ata që kanë punuar me Kuran".

Unë u tërhoqa duke bërë hapa prapa. Ndërkohë, ai zë thirri emrin tim: "Ku

Thuaju edhe shokëve të tu për Dashninë Time ndaj "ehlul-Kuran" dhe shpërblimin Tim për ty. Ata janë të përzgjedhurit më të mirë! Pasha Krenarinë dhe Madhështinë Time, nuk do ta ndëshkoj me zjarr një gjuhë që e ka lexuar Kuranin! As zemrën që e ka kuptuar atë! As veshin që e ka dëgjuar, as syrin që e ka vështruar!

është Hamza ibn Habib Ez-Zejati?" Unë thashë: Lebejke, o thirrës i Zotit!

Një melek ndërhyu dhe më tha: Thuaj: "Lebejkallahume!", pra: "Si urdhëron o Zoti im"... Dhe unë thashë: Lebejke, ashtu siç më tha.

Pastaj më futi në një vend, ku dëgjohej gumëzhitja e leximit të Kuranit, ndërsa unë dridhesha i tërë. Dëgjova një zë që më tha: "Mos u shqetëso, ngjit shkallët dhe lexo!"

Solla kokën, kur pashë një minber me smeralde të bardha, me krahë prej gurësh të çmuar të verdhë dhe shkallët prej diamantësh ngjyrë jeshilë...

Më tha: "Ngjitu dhe lexo!" Unë u ngjita. Tha: "Lexo suren "El-Enam", ndërkohë që nuk dija se kujt po i lexoja. Pasi lexova 60 ajetet e para dhe mbërrita te ajeti: "Ai është Mbizotëruesi mbi robët e Tij (61)" më tha: "O Hamza, a nuk Jam Unë Mbizotëruesi mbi krijesat e Mia?" I Thashë: Po, je! Tha: "E vërtetë. Vazhdo leximin" Dhe vazhdova derisa e plotësova këtë sure.

Më tha: "Lexo" Dhe unë nisa të lexoj suren "El-Araf". Kur mbërrita në fund të saj desha të bie në sexhde. Ai më tha: "Mjafton e kaluara (pra, në ahiret nuk ka më obligime), mos bjer në sexhde, o Hamza".

Pastaj më pyeti: "Kush ta ka mësuar ty këtë lexim?" I thashë: Sulejmani (dmth: El-Amesh). Tha: "E vërtetë. Po Sulejmanit, kush ia mësoi leximin?" Thashë: "Jahja" Tha: "E vërtetë. Po Jahja, te kush ka lexuar?" Thashë: Te Ebu Abdurrahman Es-Sulemi. Tha: "Të vërtetën ka thënë Ebu Abdurrahman Sulemiu. Po Ebu Abdurrahman Sulemiun, kush e mësoi?" Thashë: Djali i axhës i Profetit tënd, Aliu. Tha: "Të vërtetën tha Aliu. Po Aliun kush e mësoi?" Thashë: Profeti Yt, Muhamedi (a.s). Tha: "Po kush e mësoi Profetin Tim?" Thashë: Xhibrili (a.s). Tha: "Po Xhibrilin kush e mësoi?" Unë heshta.

Tha: "O Hamza, thuaj: Ti". Thashë: Nuk mund ta them (nga turpi). Tha: "Thuaje o Hamza: Ti" Unë e thashë: Ti...

Tha: "Të vërtetën the, o Hamza. Pasha hakun e Kuranit, Unë do t'i nderoj "ehlul-Kuran", (njerëzit e Kuranit, të angazhuarit me të) veçanërisht ata që punojnë me Kuran! O Hamza, Kurani është Fjala Ime dhe Unë nuk dua njeri si "ehlul-Kuran"!

Pastaj më tha: "Afrohu o Hamza" U afrova, më lyu me një erë të mirë dhe më tha: "Nuk po ta bëj vetëm ty këtë nderim, por ia kam bërë edhe shokëve të tu, më lart e më poshtë teje. Dhe kujtdo që do ua mësojë njerëzve Kuranin, sikurse ke bërë edhe ti, me sinqeritet vetëm për hatrin Tim! Ndërsa ajo që kam rezervuar për ty, o Hamza, është shumë më e madhe!

Thuaju edhe shokëve të tu për Dashninë Time ndaj "ehlul-Kuran" dhe shpërblimin Tim për ty. Ata janë të përzgjedhurit më të mirë! Pasha Krenarinë dhe Madhështinë Time, nuk do ta ndëshkoj me zjarr një gjuhë që e ka lexuar Kuranin! As zemrën që e ka kuptuar atë! As veshin që e ka dëgjuar, as syrin që e ka vështruar!"

Thashë: Subhaneke, subhaneke ja Rabbi! Tha: "O Hamza, ku janë ata që vështrojnë në Kuran gjatë leximit?" Thashë: Ja rabbi, hafizët? Tha: "Jo, atyre jua kam ruajtur shpërblimin për ditën e gjykimit, një shkallë për çdo ajet".

Pastaj, Hamzai, iu drejtua nxënësit të tij Sulejmit: "Po tash, a po më kritikon se po qaj dhe po e fërkoj fytyrën për dhé?".

Kështu, të dashurit e mi, lutja ime është që të keni përherë mbarësi e bekim, Kurani Famëlartë të jetë pjesë e pandarë e jetësë së gjithësecilit prej nesh; me të edukojmë fëmijët dhe rininë tonë, atij t'i përkushtohemi pa rezervë, duke shpresuar të kemi hise në dëshminë e Resulullahut (a.s) që na tregon se Zoti i gjithësisë ka thënë: "Atë që e angazhon Kurani nga lutja Ima, do t'i jap më mirë sesa i jap atyre që luten..."

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, 2 tetor 2021



I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë:

"Lexojeni Kur'anin, sepse në Ditën e Kiametit ai vjen ndërmjetësues (shefaat) për lexuesit e tij."

(Transmetuar nga Muslimi)

INTERVISTË ME DR. SALAHUDIN KEFTARO, MENDIMTARI I SHQUAR ISLAM NGA DAMASKU NË STAR PLUS TV

Dr. Salahudin Keftaro, mendimtar i shquar Islam, i ftuar në emisionin "Studio e Hapur" e gazetarit Senad Nikshiqi, në Tv Star Plus - 15 tetor 2021

- Gazetari: Sot do të kem nderin të kem në studio Dr. Selahudin Keftaro, i cili është një dijetar islam, vjen nga Siria dhe është e disata herë që vjen në qytetin e Shkodrës, duke krijuar një lidhje të fortë me këtë qytet, por edhe me komunitetin mysliman të Shkodrës.

Faleminderit shumë për ftesën dhe mirë se ju kam gjetur, ju falënderoj edhe një herë, sepse po më jepni mundësinë në televizionin tuaj Tv Star Plus që të komunikoj me qytetarët e Shkodrës.

- Gazetari: Cila është arsyeja e zotëri Keftaros sërish në Shqipëri, fillimisht?

Përmes asaj që Zoti i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë: "O ju njerëz ne ju kemi krijuar në popuj dhe fise që të njiheni me njëri-tjetrin", ne gjithmonë rendim që të njohim njëri-tjetrin, përmes kulturës së tyre tradicionale dhe përmes dialogut konstruktiv që na bashkon me njëri-tjetrin.

Por, në fakt unë këtu në vendin tuaj kam një histori shumë të mrekullueshme dhe të gjatë me një grup të nderuar studentësh, të cilët kanë studiuar në shkollën dhe universitetin tonë, në Damask të Sirisë dhe të cilët tashmë janë kthyer në vendin e tyre në Shqipëri. Ata janë siguria e shoqërisë, janë mjek shpirtëror dhe jo gjykatës apo xhelat. Në ballë të këtij grupi të studentëve të nderuar, është Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili më ka nderuar me ftesën që më ka bërë që të vizitoj Shkodrën për herë të tretë.

Kjo, nëse tregon për diçka, tregon se familja jonë është e njëjtë, është pikërisht familja e besimit, familje njerëzore. Në zemrën time kam një respekt dhe nderim për vendin tuaj, sepse sigurisht ka gjëra të tjera, të cilat na bashkojnë përmes Shqipërisë dhe Sirisë.

Adresa e përbashkët qe kemi të gjithë bashkë është: Të jetuarit mes myslimanëve dhe të krishterëve. Ashtu si sot këtu në Shkodër minaret janë përkrah kompanieleve, kështu janë edhe në Siri përkrah njëra-tjetrës. Kjo është feja qiellore. Këtë ka pasur për qëllim Zoti ynë për ne; Që të jemi vëllezër, duke dashur njëri-tjetrin edhe nëse kemi besime dhe diversitete të ndryshme, por emëruesit që na bashkojnë janë shumë me tepër.

- Gazetari: Shqipëria është një vend i veçantë për zotëri Keftaron?

Unë kam vizituar me shumë se 60 shtete në 5 kontinente, por me të vërtetë kur vij në Shqipëri, ndihem sikur nuk kam dalë nga vendi im. Sa herë që vij, pra vizitojë këtë qytet, më shtohet dashuria dhe respekti për këtë vend, përmes njerëzve të denjë që ka ky vend, përmes klerikëve të krishterë që jam takuar me ta, përmes disa politikanëve me të cilët jam takuar, gjithashtu edhe me dijetarët dhe thirrësit e fesë islame.

- Gazetari: Zotëri Sytari, Myftiu i nderuar ka qenë student i zotëri Keftaros, si ishte ai si student?

Myftiun e nderuar sot unë e konsideroj sikur është profesori im, sepse ka qenë student në universitetin tim atje. E konsideroj mësues tonin për shkak të asaj që mban prej mendimeve dhe metodës së tij, duke rrezatuar dashuri dhe mirësi për të gjithë njerëzit dhe ky është mesazhi i vërtetë i Islamit. Në mendimin dhe në zemrën tim, ai është shembull i gjallë për një Islam që të rinovon. Me shembujt e tij dhe thirrjen islame që e propagandon i thotë njerëzve: ne jemi vëllezër dhe duhet të përqafojmë njëri-tjetrin. Kjo është pjesë e rëndësishme e misionit në fenë tonë. Këtë e kam parë edhe tek i nderuari Shejkh Sytari në Shqipëri dhe si rrjedhojë kjo dashuri më shtohet ditaditës.

- Gazetari: Duket sikur kohët po ndryshojnë, a kishin të rinjtë të njëjtin entuziazëm si vite më parë si zotëri Sytari?

Universiteti jonë, ose Akademia "Shejkh Ahmed Keftaro" në Siri është një universitet islam ndërkombëtar. Në fakt, ky universitet në sytë e tjerëve është një bashkim i kombeve të ndryshme islame. Ka pasur studentë e studente mbi 80 kombësi të ndryshme të botës, ku mësonin gjuhën arabe dhe shkencat islame që të kthehen në vendet e tyre si mjekë për të shëruar zemrat e njerëzve, idetë e tyre si dhe mënyrën e të jetuarit sipas parimeve islame.

Ky universitet i dijes dhe e shkencës, nuk është përqendruar vetëm në arsimimin e njerëzve, por edhe në organizimin çdo ditë të pritjeve dhe përcjelljeve të dhjetëra delegacioneve të ndryshme jo islame që vinin nga

vende të ndryshme të botës, për t'u njohur me Islamin, dhe civilizimin e tij në kohë të ndryshme.

Në fillim të shekullit 21, sfidat me të cilat përballet njeriu i sotëm sigurisht që po përballet edhe Islami. Prandaj ne dëshirojmë t'ia prezantojmë të tjerëve Islamin dhe qytetërimin tonë, sikur kërkojmë që të mësojmë nga të tjerët, besimin, kulturën dhe qytetërimin e tyre. Kjo arrihet përmes dialogut jo me të mirën, por me atë që është edhe më e mirë, siç thotë Kur'ani Famëlartë.

- Gazetari: Cila është ajo gjëja kryesore ose thelbi që përbën shkollën Keftaro në Siri?

Këtë akademi dhe universitet e ka themeluar vetë Shejkh Ahmed Keftaro (Allahu e mëshiroftë). Idetë e tij kanë qenë për mesatarizëm dhe drejtësi. Gjithë jetën e tij ia ka kushtuar njerëzimit dhe familjes. I është sjellë me vizitat e tij gjithë globit nga Japonia në Amerikë, nga Jugu i Afrikës deri në veri të Bashkimit Sovjetik të asaj kohe. Pas dialogëve dhe bisedave që mbante hirësia e tij, gjithmonë thoshte: "Unë kurrë nuk kam parë njëri, i cili nuk ka mirësi në të, por topi është tek ne, njerëzit fetar, tek prijësit fetar. Kur t'ia prezantojmë të tjerëve fenë me bukurinë dhe madhështinë e saj, ashtu siç ka zbritur nga Zoti, atëherë njerëzit do ta nderojnë dhe respektojnë fenë".

Qëllimi jonë nuk është që bota të islamizohet, por që t'i njohim ato me vlerat tona, sikurse edhe ne dëshirojmë të mësojmë për kulturën dhe fenë e tyre, sepse njeriu është armik i asaj që nuk e di. Kur njerëzit afrohen vëllazërisht me njëri-tjetrin edhe në distanca të largëta, aty ka një dialog konstruktiv, dhe si rezultat do të shohim se gjërat që i bashkojnë janë më shumë se gjërat që i ndajnë nga njëri-tjetri.

- Gazetari: Në fakt zotëri Keftaro edhe në takimin që pati në Shkodër foli për myslimanët dhe për terrorizmin që shpesh i bëjnë bashkë ose i ngjeshët myslimanizmit ideja e terrorizmit dhe ideja e ekstremizmit, nuk e di cila do të ishte përgjigjja e tij ose si ndjehet në rolin e dijetarit kur kjo ndodh dhe cili është ai mesazh që kërkon të japë sot?

Sigurisht pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit, të dhimbshme dhe të dënuara, që në atë kohë ka shumë akuza në emër të islamit dhe ndaj myslimanëve. Por në përgjithësi them se, kur shohim se Islami nxit për vëllazëri dhe për bashkim dhe bashkëjetesë me njëri-tjetrin, atëherë konfirmoj se çdo veprim që nuk ka lidhje me parime është i dënueshëm. Kam bindjen se terrorizmi dhe ekstremizmi dhe të gjithë ato format e dhunshme nuk kanë fe, as komb dhe as ndonjë vlerë. Ashtu siç sot akuzohen myslimanët për terrorizëm dhe ekstremizëm, në anën tjetër shohim se ato persekutohen dhe vriten para syve të botës. Unë nuk mund të jem përgjegjës për një mysliman, i cili nuk është në rregull nga ana mendore ose ekstremist që i shërben disa projekteve që janë kundër Islamit. Unë jam përgjegjës për parimet dhe bazat e Islamit të bazuara në Kur'an dhe në udhëzimet profetike.

Unë si njeri i fesë i them njerëzve se Zoti i Madhëruar thotë në Kur'an: "Ai që vret me pa të drejtë ose bën shkatërrime në tokë është sikur të ketë vra të gjithë njerëzimin dhe kush bëhet shkak që të jetojë është sikur të ketë bërë që të jetojë të gjithë njerëzia". Ndërsa, Pejgamberi (a.s) thoshte për Qaben e Madhërueshme që: "Sikur Qabja të shkatërrohet gurë-gurë është më e lehtë (më pak gjynah) se sa të vritet një njëri i pafajshëm". Por, kur shohim një pakicë krejt të vogël të ekstremistëve myslimanë apo nga ata që e kanë pranuar Islamin, fenomenin e ekstremizmit e shohim edhe tek fetë e tjera. Pra, nga këtu themi që ekstremizmi dhe terrorizmi nuk ka fe e as komb.

Origjina dhe baza që na motivon është që të jemi vëllezër, duke dashur njëri-tjetrin, të takohemi me njëri-tjetrin dhe të jetojmë në këtë tokë duke ndërtuar personalitetin e njeriut, me qëllim për të fituar xhenetin e botës tjetër të amshuar. Jo vetëm kaq, por nuk mund të pranoj që të gjithë



Kompleksi Islam më i madh në Lindjen e Mesme **"Shejkh Ahmed Keftaro"** Damask, Siri

myslimanët të quhen terrorist apo ekstremist, kur numri i tyre ka kaluar një miliard e shtatëqind milionë. Sipas përllogaritjeve botërore ata që i quajnë terrorist apo ekstremist nuk janë as dhjetë mijë të tillë. Dhe sigurisht për këto ekstremistë, të kujtdo qofshin duhet të ndiqen nga vetë qeveritë e vendeve të tyre, sipas ligjeve që kanë.

- Gazetari: Është e vështirë për ti bindur njerëzit për ta kuptuar këtë sepse dihet se ka një pjesë që e besojnë se dikush mund të arrijë deri aty sa mund të vrasë në emër të fesë apo në emër të Zotit është e vështirë për t'i bindur njerëzit, për ta bindur botën?

Islami nuk e lejon që të vritet dikush me pa të drejtë. Nëse ka vrarë dikë, gjykimi ndaj tij duhet të jetë përmes gjykatave dhe ligjeve të shtetit. Në fakt, ne nuk duam që ky njeri që ka bërë çrregullime në tokë të vritet, por duam që të vrasim sëmundjen e tij, dhe jo të sëmurin, sepse janë ideologjitë e gabuara, të cilat e drejtojnë njeriun drejtë ekstremizmit dhe vrasjes. Prandaj detyra jonë si fetarë është që ta shpëtojmë këtë njëri nga kjo sëmundje, nga ky kancer dhe të mbysim sëmundjen që ka në mendimin e tij.

- Gazetari: Është e drejtë që shumë shtete të Evropës po mbyllin dyert e tyre përmes kufijve, kuptohet pikërisht për shkak të asaj lloj frike?

Unë besoj se mbyllja e kufijve më shumë ka të bëj me refugjatët se sa me frikën e ekstremizmit. Çdo ditë emigrimi në vendet perëndimore po shtohet veçanërisht nga brezi ri, të cilët kërkojnë mundësi punësimi ose arratisen nga shkelja dhe dhunimi i të drejtave të njeriut në vendet e tyre.

Sigurisht është e drejtë e këtyre shteteve të vendosin rregulla për t'i kontrolluar në pranimin apo kthimin e tyre si dhe në mënyrë që të sigurohen që të mos të depërtojnë diçka, që nuk është e mirë dhe që përmes këtyre refugjatëve të mos pranohen persona ekstremist.

Në këtë kontekst unë i kam bërë disa herë thirrje qeverive në perëndim, që të ndalojnë largimin e myslimanëve për në vendet e tyre problematike. Sikundër i kam bërë apel qeverive perëndimore që të ndërtojnë institucione islame, që bazohen në ide të mesme dhe të moderuara, ku përmes tyre të dërgohen fëmijët e këtyre emigrantëve që të mësojnë Islamin, pikërisht mbi ato baza që unë përmenda.

Jo vetëm kaq, por ne e kemi librin

Gjatë vizitës së Papës
Gjon Pali II
në Damask, Siri - 2001

e hapur me të gjithë, ne nuk fshehim asgjë.

Pra, le të jenë këto institucione islame në perëndim dhe të përvetësojnë dhe të shkollojnë fëmijët e tyre , në mënyrë që të mos shkojnë në vendet e tjera dhe të infektohen me ideologji ekstremiste. Sikurse them, që të marrin, dijetarë dhe thirrës islam të afirmuar për mesatarizëm dhe të urtë, të cilët në fakt janë pjesa më e madhe, që t'i japin mësim këtyre deri që të diplomohen nga këto institucione.

- Gazetari: Rasti i fundit në Norvegji i cili vrau pesë të tjerë me hark dhe me shigjetë pothuajse si në skena filmash dhe më pas në media u tha se ky person është konvertuar pak kohë më parë në mysliman. Si ndihet kur dëgjon për ngjarje të tilla kur i përvishen Islamit?

Çdo vepër që ka të bëjë me një vepër terroriste është vepër frikacaku dhe nëse është mysliman. Kjo është refuzuar dhe e dënueshme në fenë tonë. Ky rast më kujton edhe rastin tjetër në Zelandën e Re, të para dy viteve, kur një person i cili pretendonte se ishte i krishterë hyri në xhami dhe vrau më shumë se pesëdhjetë persona, të cilët po faleshin. Si myslimanë, nuk thamë se ai është një terrorist i krishterë, por thamë që është një ekstremist, racist, sepse Jezui, (Hz. Isai a.s) ka qenë larg këtyre veprave të shëmtuara dhe ka thënë: "Duajeni atë që ju urren dhe begatojeni ata që ju afrohen". Gjithashtu ka thënë:. "Ai që ju godet në njërën faqe, ktheja edhe faqen tjetër". I cili thoshte: "Lum ata që prodhojnë paqe për krijesat e Zotit"!

Ndërsa Pejgamberi Muhamed (a.s) në lidhje më këtë ka thënë: "Nuk do të hyni në xhennet deri sa të besoni, dhe nuk do të besoni derisa ta duani njëri-tjetrin. A ju tregoj për diçka, që nëse me të vërtetë do ta bëni, do të duheni me njëri-tjetrin? Përhapni paqen mes jush". Prandaj them se vrasësi, qoftë mysliman apo i krishterë, nuk ka lidhje as me Islamin e as me krishterimin, por është një njeri ekstremist, i cili duhet të shërohet përmes drejtësisë dhe ligjeve të vendit të tij.

- Gazetari: Sa i rëndësishëm është muaji i Mevludit, ditëlindja e Profetit Muhamed dhe cila është ideja e rahmes (mëshirës), besoj kjo është edhe arsyeja e cila ka ardhur edhe në Shqipëri Keftaro?

Kur përkujtojmë lindjen e profetit Muhammed (a.s), ne nuk përkujtojmë lindjen e tij fizike dhe trupore, por përkujtojmë ose festojmë lindjen e drejtësisë, lindjen e barazisë, lindjen e vëllazërisë dhe paqes për të cilën ka thirrur ky Profet i madh, lindjen e dijes dhe shkencës, e cila arriti të triumfojë ndaj injorancës. Ai (a.s) ka thënë: "Nuk është prej meje ai, i cili nuk është mësues ose nxënës (kërkues) i dijes". Ai thoshte: "Gjithë njerëzit janë familja e Zotit, dhe më i dashur tek Ai është ai që është më i dobishëm për familjen e tij". Po ashtu thoshte: "Se nuk ka besuar ai i që fle në darkë i ngopur dhe fqinji i tij është i pangopur". Kur shtohej persekutimi nga zullumqarët ai drejtohej nga Zoti dhe lutej: "O Zot drejtoje popullin tim se ato nuk dinë çfarë bëjnë". Atëherë, si myslimanë duhet të gëzojmë dhe të përkujtojmë këtë Pejgamber të madh, sikurse festojmë dhe gëzojmë lindjen e Hz. Jezusit, (Isait a.s).

- Gazetari: Sa të rëndësishme janë marrëdhëniet ndërfetare mes popujve dhe kombeve?

Marrëdhëniet ndërfetare janë të

vërtetuara me Kur'an dhe me traditën profetike. Zoti i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë: "Ata të cilët kanë besuar, atë që u bënë hebre, të krishterët dhe Sabinët, të cilët kanë besuar Allahun, Ditën e Gjykimit dhe bëjnë vepra të mira, ata do të kenë shpërblimin tek Zoti i tyre dhe nuk do të kenë frikë e as dëshpërim për ta". Profeti ynë Muhammed (a.s) thoshte: "Ne familja e profetëve jemi vëllezër, feja jonë është një, dispozitat i kemi të ndryshme".

Nga këtu kuptojmë se e kemi obligim që të takohet myslimani me të krishterin, me pjesëtarët e të gjitha feve, sepse gjërat e përbashkëta janë shumë më tepër se ato që na ndajnë me njëri tjetrin. Gjithë ne e duam lulen e bukur, çdo kush nga ne e dëshiron aromën e mirë. Ne kur i prezantojmë fetë, se ato bashkojnë dhe nuk përçajnë, të cilat ftojmë për dashuri, vëllazërim dhe bashkëpunim me njëri-tjetrin, atëherë si të mos i duam dhe si të mos i pasojmë këto fe qiellore. Nëse flasim për popujt, topi nuk është në anën e tyre, por në anën e feve, të cilët duhet t'i bashkojnë popujt e ndryshëm. Nëse njerëzit i kuptojnë fetë ashtu siç kanë zbritur nga qielli dhe e pranojnë me zemrat e tyre, atëherë ne do jetojmë si një familje e vetme. Kështu unë e kuptoj fenë. Feja është marrëdhënie, feja është paqe, vëllazëri dhe dashuri.

- Gazetari: A ka dilema për botën të cilën po jetojmë, a ka sfida të mëdha, cilat janë pritshmëritë, cili është botëkuptimi që ka zotëri Keftaro?

Për fat të keq, sot ne jetojmë përballë sfidave dhe krizave shumë të mëdha. Por unë jam shumë optimist në përballimin dhe zgjidhjen e tyre. Besoj se në një kohë të afërt do të dalim nga gryka e ngushtë e shishes, pra nga këto sfida. Ne jemi në atë gjendje siç është ajo gruaja në prag të lindjes. Ka me të vërtetë një rënie në krejt sistemin njerëzor. Pandemia e koronavirusit e shtoi më tepër krizën, shto këtu edhe ato akuza që i drejtohen myslimanëve sikur ndjekin një "fe terroriste"; shtuar këtu edhe pa drejtësi shumë të tjera në botë. Por, kur të gjithë kthehemi tek ligji hyjnor, atëherë do të jetojmë një jetë të kënaqshme, do të ndërtojmë vendin dhe njerëzit tanë me moralin e bukur, duke e respektuar dhe dashur njëri-tjetrin. Ne nuk jemi ndryshe vetëm se një familje e vetme, prandaj është obligim për ne që të njihemi dhe të përqafojmë njëri-tjetrin, që të vendosim hartën e rrugës që t'ia ndriçojmë rrugën brezit të ri, kushdo qofshin, myslimanë, të krishterë, hebre apo ithtarë të ndonjë feje tjetër. Unë jam shumë optimist se e ardhmja e afërt do jetë e qeshur dhe e ndritur. Kjo nuk do të thotë se unë duhet të jem thjesht optimist, por duhet të eci pas këtij manuali, që të arrijmë së bashku me pjesëtarët e feve të tjera dhe popujt e ndryshëm, të ndërtojmë vendin tonë, brezin tonë dhe të ardhmen tonë.

- Gazetari: Ju thoni se Islami është fe e shekullit 21, a jeni të sigurt për këtë?

Këtë fjalë e kam dëgjuar nga babi im, Myftiu i Sirisë, Shejkh Ahmed Keftaro. Kjo fjalë nuk do të thotë që e gjithë bota të besoj në Islam, por që mbarë bota ta njoh e ta mësojë këtë fe, e cila ka urdhëruar për paqe, ka urdhëruar për dashuri, për bashkim me njëri tjetrin. Nëse unë dua që e gjithë bota të islamizohet, unë kam dalë nga rruga e Zotit, nga rruga kur'anore. Zoti ynë thotë në Kur'an Famëlartë: "Sikur Zoti yt të kishte dashur, do të kishin besuar të tërë ata që janë në tokë; A t'i do t'i detyrosh njerëzit të besojnë!?"

Zoti i Madhëruar ka dashur që njerëzit të jenë si ato lulet, të cilat kanë ngjyra dhe aromë të ndryshme. Prandaj, nuk mund ta ndryshojmë sistemin e Tij në këtë univers. Kur themi se shekullit 21, është shekulli i Islamit, unë kam aspirata, që ky Islam të mbërrij në çdo shtëpi në perëndim, pikërisht Islamin bazë dhe të origjinës. Përmes stacioneve televizive satelitore i them mbarë botës se ne jemi pjesë e kësaj shoqërie njerëzore, duam që të jetojmë në vëllazëri në paqe, duam që të ndërtojmë dhe të kemi një të ardhme më të mirë.

- Gazetari: Jemi në fund, nëse ke një mesazh të shkurtër para se ta mbyllim?

Mesazhi im për këtë popull të mrekullueshëm në Shqipëri është që ta shtojnë dashurinë mes njëri-tjetrit, vëllazërinë dhe bashkëpunimin dhe ta ndërtojnë këtë vend të mrekullueshëm. Njëkohësisht ju përcjelli përshëndetjet më të përzemërta nga gjithë populli sirian, që nga prijësit fetarë atje e deri tek njerëzit më të thjeshtë.

E lus Zotin që ta mbani këtë paqe, këtë mirësi dhe begati që keni në këtë vend si dhe këtë bashkëjetesë me njëri-tjetrin, bashkëjetesën mes myslimanëve dhe të krishterëve, të cilët me të vërtetë e shohim si shembull për mbarë botën.

Përktheu intervistën: **Lavdrim Hamja**

Diktoi intervistën: **Arben Halluni**



Shejkh Muhamed El-Gazali
(1917 - 1996)

"Lënia e fatit të popujve në dorën e mendjelehtëve është shkak për shkatërrimin e të gjithëve, të prishurve dhe të udhëzuarve..!

Duhet të lëvizin të zotët e mendjes për të shpëtuar anijen e rrezikuar:

"Nuk ka për t'i shkatërruar padrejtësisht Zoti yt vendbanimet, ndërkohë që banorët e tyre janë vepërmirë". - (Kur'ani, Hud: 117)

Prandaj, a duhet të heqim dorë prej urdhrave dhe ndalesave?

A duhet të përtojmë në mbrojtjen e kufijve të Allahut?

Dhe, a duhet tua lëshojmë fushën njerëzve batallë dhe me epshe?"

BURKINA FASO

Burkina Faso është shtet në Afrikën Perëndimore, që nuk ka dalje në det. Ky shtet rrethohet nga Mali në veri dhe veriperëndim, Nigeri në lindje, Benini në juglindje, Togo dhe Gana në jug, dhe nga Bregu i Fildishtë në jugperëndim.

Burkina Faso ka një sipërfaqe prej 274.200 km 2, dhe një popullsi prej 21.661.925 banorësh (sipas worldometers.info, Tetor, 2021).

Kryeqyteti i vendit është **Ouagadugu**.

Emri i vendit 'Burkina Faso', është i përbërë nga tri gjuhët e etnive me numrin më të madh të popullsisë në vend: Gjuha Mussi (që janë banorët autoktonë dhe që përbëjnë shumicën), gjuha Diula ose Bambara, dhe gjuha Fula, të cilës i takon merita për përhapjen e Islamit në Burkina Faso.

Fjala 'Burkina', sipas gjuhës Mussi, do të thotë: Vendi i njerëzve të lirë, të nderuar dhe fisnikë, dhe i njerëzve të pastër. Kurse fjala 'Faso', sipas gjuhës Bambara, do të thotë 'Atdheu im'. Kombinimi midis këtyre dy termave tregon për krenarinë dhe dashurinë që ky popull kanë për atdheun. Gjëja e çuditshme në lidhje me përkatësinë kombëtare për banorët e Burkina Fasos është se ajo nuk i nënshtrohet asnjërit prej rregullave gjuhësore, pasi banorët e këtij vendi quhen 'Burkinabei', term i marrë nga gjuha e tretë më e përhapur në vend, gjuha Fula. Kështu, emri i shtetit Burkina Faso përbëhet nga dy gjuhët më të përhapura në të, kurse përkatësia kombëtare është marrë nga gjuha e tretë.

GJEOGRAFIA

Burkina Faso ndodhet në një rrafshnaltë të gjerë, e cila shkon e pjerrët drejt jugut. Shtresa laterike e shkëmbit që mbulon shkëmbinjtë kristalorë të gjendur poshtë tyre, është e prerë thellë nga tre lumenjtë kryesorë të vendit: Volta e Zezë, Volta e Kuqe dhe Volta e Bardhë, ku të gjithë këta lumenj bashkohen në Gana, në jug, për të formuar Lumin Volta. Oti, një tjetër degë e Voltës, shtrihet në juglindje të Burkina Fasos. Në rrjedhën e lumenjve ndodhin ndryshime të mëdha sezonale, ku disa prej tyre, gjatë sezonit pa shi, kthehen në shtretër të thatë. Në jugperëndim të vendit gjenden pllaja ranore, që kufizohen nga Skarpata Banfora. Pjesa më e madhe e tokës në vend është jopjellore.

KLIMA

Burkina Faso ka një klimë përgjithësisht me diell, të nxehtë dhe të thatë. Atje mund të dallohen katër stinë: stina e thatë dhe e ftohtë (që zgjat nga mesi i Nëntorit deri në mes të Shkurtit, me temperatura që bien në rreth 16 ° C gjatë natës), stina e nxehtë (që zgjat nga mesi i Shkurtit deri në Qershor, kur temperaturat maksimale ngrihen në rreth 40 ° C, nën hije), stina me shi

(zgjat nga Qershori deri në Shtator), dhe stina e ndërmjetme (e cila zgjat nga Shtatori deri në mes të Nëntorit). Reshjet vjetore të shiut ndryshojnë nga rreth 1000 mm në jug, në më pak se 250 mm, në veri.

Pjesa veriore e vendit mbulohet nga savana, me shkurre me gjemba dhe pemë jo të larta, që lulëzojnë gjatë sezonit të shirave. Në jug, shkurret me gjemba u japin rrugë pyjeve të shpërndarë, të cilët bëhen më të dendur përgjatë brigjeve të lumenjve.

EKONOMIA

Agrikultura përfaqëson 32% të prodhimit të brendshëm bruto të Burkina Fasos, dhe punëson rreth 80% të fuqisë punëtore në vend. Kjo konsiston kryesisht në rritjen e bagëtive. Në jug dhe në jugperëndim të vendit, njerëzit kryesisht kultivojnë sorgum, mel, misër, kikirikë, oriz dhe pambuk. Një pjesë e madhe e veprimtarisë ekonomike të vendit financohet nga ndihmat ndërkombëtare.

Kushtet e vështira ekonomike, të përkeqësuar nga thatësirat e rënda të herëpashershme, kanë provokuar migrim të konsiderueshëm brenda Burkina Fasos (nga zonat rurale në ato urbane), por edhe në vendet fqinje.

Zhvillimi i industrisë në Burkina Faso është penguar nga masa e vogël e ekonomisë së tregut dhe nga mungesa e një daljeje direkte në det. Duke filluar nga fundi i viteve 1990, qeveria filloi të privatizonte disa njësi shtetërore me qëllim tërheqjen e investimeve të huaja.

GJUHA

Burkina Faso është një vend ku fliten më shumë se 60 gjuhë, ndër të cilat më e përhapura, veçanërisht në kryeqytet, është gjuha Mussi. Megjithatë, gjuha zyrtare në vend është frëngjishtja, e cila hyri në Burkina Faso gjatë kolonializmit. Frëngjishtja është gjuha kryesore e institucioneve administrative, politike dhe gjyqësore, e shërbimeve publike dhe e shtypit, dhe është gjuha e vetme e përdorur për ligjet, administratën dhe gjykatat.

Gjuha Arabe është e përhapur atje, gjithashtu. Një studim i publikuar në vitin 2003, tregon se 63% e nxënësve mësojnë arabisht në shkollat fetare, dhe se popullsia, veçanërisht ajo myslimane, preferojnë arabishten përpara frëngjishtes.

FEJA

Në vitin 2006, qeveria e Burkina Fasos raportoi se 60.5% e popullsisë praktikojnë Islamin, ku shumica e tyre i përkasin Islamit Sunit; 23.2% e popullsisë janë të krishterë, kurse 15.3% ndjekin besimet tradicionale autoktone.

HISTORI

Sipas të dhënave historike, në periudhën 1400 - 5000 p.e.s, pjesa veriperëndimore e Burkina Fasos së sotme ka qenë e populluar nga gjahtarë. Mjetet e tyre, si kruajtëset, daltat dhe shigjetat, u zbuluan në vitin 1973, përmes gërmimeve arkeologjike. Vendbanimet bujqësore u krijuan atje midis viteve 3600- 2600 p.e.s. Kultura Bura ishte një qytetërim i epokës së hekurit, i përqendruar në pjesën jugperëndimore të Nigerit të sotëm dhe në pjesën juglindore të Burkina Fasos bashkëkohore. Industria e hekurit, për shkrirjen dhe farkëtimin e mjeteve dhe armëve, u zhvillua në Afrikën Sub-Sahariane rreth viteve 1200 para Isait (a.s). Nga shekujt 3 - 13 pas Isait (a.s), kultura Bura e Epokës së Hekurit ekzistonte akoma në zonën juglindore të Burkina Fasos së sotme, dhe në zonën jugperëndimore të Nigerit.

Grupe të ndryshme etnike të Burkina Fasos së sotme, të tilla si Mussi, Fula dhe Diula, arritën atje në valë të njëpasnjëshme, në shek. 8 - 15. Etnia Samo mbërritën aty rreth shekullit të

Xhamia më e madhe në Burkina Faso me arkitekturë balte

15-të. Dogon jetoi në rajonet veriore dhe veriperëndimore të Burkina Fasos, diku në shekujt 15 ose 16, dhe shumë nga grupet e tjera etnike që përbëjnë popullsinë e vendit mbërritën në rajon gjatë kësaj kohe.

Gjatë Mesjetës, Mussi-t krijuan disa mbretëri të ndara, përfshirë ato të Zandoma,Tenkodogo, Ouagadugu dhe Jatenga.

Gjatë shekullit të 18 –të, në Bobo Diulasso u krijua Perandoria Guiriko, dhe përgjatë Voltës së Zezë u vendosën grupet etnike Dian, Lobi dhe Birifor.

Në fillim të viteve 1890, një seri oficerësh ushtarakë britanikë, francezë dhe gjermanë, bënë përpjekje për të marrë pjesë të asaj që sot është Burkina Faso. Nganjëherë këta kolonialistë dhe ushtritë e tyre luftuan me popujt vendas, e nganjëherë lidhën aleanca me ta dhe bënë traktate.

Përmes një serie komplekse ngjarjesh, ajo që sot është Burkina Faso, në vitin 1896, u bë përfundimisht një protektorat francez, dhe u bë e njohur si Volta e Epërme. Kur myslimanët në Voltën e Epërme bënë përpjekje për të fituar pavarësinë e tyre, kolonialistët e copëtuan tokën e tyre, dhe e shpërndanë atë mes Bregut të Fildishtë, Malit dhe Nigerit. Në vitin 1947, Volta e Epërme rifitoi unitetin e tokave të saj nën një koloni të vetme, dhe në vitin 1960 ajo fitoi edhe pavarësinë.

Kryeqyteti, Ouagadugu

Në vitin 1987, Volta e Epërme e ndryshoi emrin në 'Burkina Faso'.

SI HYRI ISLAMI NË BURKINA FASO

Historia na tregon se marrëdhënia e Islamit me Afrikën ka lindur që në agimin e Islamit. Profeti i nderuar - paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të - u pati sugjeruar shokëve të tij të emigronin në tokën e Abisinisë (në Afrikë), sepse ishte një vend ku mbahej drejtësi. Kështu që Afrika u njoh me Islamin që në kohët më të hershme të tij.

Kur flasim këtu për Islamin në Burkina Faso, çfarë thuhet për këtë rajon mund të thuhet edhe për në çdo vend tjetër musliman të Afrikës Perëndimore, në përgjithësi. Historia e hyrjes së Islamit në Burkina Faso daton që në shekujt e katërt, të shtatë ose të nëntë të Hixhretit, dhe kjo ndodhi përmes lëvizjeve tregtare. Burkina Faso nuk është një nga vendet ose qytetet që kanë hyrë në Islam me marrëveshje, dhe as me forcë, e për këtë arsye në këtë zonë nuk tregohet të këtë ekzistuar taksa, as të ketë pasur ndonjë kalife dhe as ndonjë guvernator të caktuar nga perandoria Islame asokohe.

Sot Islami përhapet fuqishëm në Burkina Faso përmes ndërtimit të xhamive, predikimit në televizionin kombëtar, njohjes zyrtare të festave islame dhe nëpërmjet mbështetjes që vjen nga Bota Arabe.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

- *https://www.smoketreemanor.com*
- *https://en.wikipedia.org/wiki*
- *https://ar.wikipedia.org*
- *http://islamion.com/news*
- *https://www.britannica.com*

VLERA E KËRKIMIT TË FALJES NË AJETET KURANORE

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Kur të shohësh që po të vonohet risku, shto kërkimin e faljes (Istigfarin).

Kur ne themi "Estagfirullah", nga Allahu (xh.sh) kërkojmë dy gjëra:

1- Kërkojmë nga Allahu i Madhëruar që të na ruajë nga pasojat e të këqijave, që mund të na sjellin gjynahet, dënimet e ndryshme, etj.

2- Kërkojmë nga Allahu i Lartësuar që të na i mbulojë të metat dhe mos të turpërohemi përpara të tjerëve me gjynahet tona. Imam Ebu Hanife (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: "Sikur gjynahet tona të kishin erë, askush nuk do kishte mundësi të qëndronte afër njëri-tjetrit".

Kjo fjalë është e shkurtër dhe e lehtë për gjuhën, por shumë e rëndësishme dhe e dobishme për besimtarin në jetën e kësaj bote.

Nëpërmjet istigfarit ne tregojmë dobësinë dhe paraqesim nevojën tonë tek Allahu i Madhëruar. Profeti (a.s) i porosiste shpesh shokët e tij duke u thënë: "O njerëz, pendohuni te Zoti sinqerisht! Kërkojini falje Zotit për gjynahet që keni bërë! Unë i kërkoj falje Allahut dhe pendohem tek Ai 100 herë në ditë."[1] Ai që i kishte gjynahet dhe gabimet e falura te Zoti e thoshte këtë fjalë deri në 100 herë në ditë, po ne që jemi të mbushur me gjynahe e gabime sa herë në ditë duhet që ta themi këtë fjalë?

Ebu Hurejra (r.a) ka thënë: Unë në ditë bëj 12.000 herë istigfar. Njerëzit e kanë pyetur përse 12.000 herë? Ai ka thënë: Allahu (xh.sh) më ka falur një shpirt dhe ia kam borxh Atij. Në atë kohë nëse dikush vriste dikë, duhej të shpagonte gjakun e tij. Shpagimi i gjakut në atë kohë ka qenë 12.000 dinarë. Shpirtin që unë kam, Allahu (xh.sh) ma ka dhënë të pastër, por unë e kam njollosur atë me gjynahe dhe dua që ta shpaguaj atë duke bërë istigfar.

Në dorën tonë kemi lapsin dhe gomën. Nëse gabimisht kemi shkruar diçka që nuk duhet e kemi mundësinë për ta fshirë atë. Goma është istigfari. Kjo mirësi nuk zgjat gjithmonë. Kur njeriu vdes, i merret edhe lapsi edhe goma.

Katade (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: "Kurani na tregon për sëmundjet dhe për shërimin. Sëmundjet janë gjynahet, ndërsa shërimi i tyre është istigfari".

Vlera e kërkimit të faljes (istigfarit) në ajetet kuranore

1. Istigfari është shkak për faljen e gjynaheve. Allahu i Madhëruar na i falë gjynahet tona nëse ne kërkojmë falje sinqerisht prej Tij. Allahu (xh.sh) në Kuran na tregon që Nuhi (a.s) i ka thënë popullit të tij: O popull: "Kërkoni falje nga Zoti juaj, i Cili është Falës i madh".[2]

"Kush bën ndonjë të keqe apo e ngarkon veten me gjynahe, pastaj kërkon falje tek Allahu, ai do ta gjejë Allahun Falës dhe Mëshirues".[3]

2. Istigfari është shkak për zbritjen e mëshirës hyjnore. Salihu (a.s) i tha popullit të vet: "O populli im, përse ju e dëshironi të keqen para së mirës?! Përse nuk kërkoni nga Allahu falje (të gjynaheve) që të mëshiroheni?"[4]

Hasen El-Basriu (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: "Shpeshtojeni kërkimin e faljes nga Allahu:

- në shtëpitë tuaja
- në lagjet tuaja
- në tregjet tuaja
- në qëndrimet tuaja, dhe
- kudo që të jeni, sepse ju nuk e dini kur zbret mëshira e Tij".[5]

3. Istigfari është shkak për zbritjen e bereqetit. "Ai do t'ju dërgojë nga qielli shi të bollshëm".[6]

4. Istigfari është shkak për shtimin e pasurisë dhe fëmijëve. Allahu (xh.sh) thotë: "Ai do t'ju begatojë me pasuri dhe fëmijë".[7] Tregohet se një person kishte tetë vite i martuar dhe nuk kishe fëmijë. Gjatë kësaj kohe ishte vizituar në shumë doktorë. U ishte nënshtruar për tetë vite shumë udhëzimeve mjekësore, por përsëri ishte pa fëmijë. Atëherë, u drejtua tek një dijetar, i cili e këshilloi të shpeshtonte sa më shumë istigfarin. Duke iu përmbajtur istigfarit, bashkë me gruan e tij, brenda vitit, ky çift, u bë me fëmijë.

1. Transmetuar nga Muslimi.

2. Kuran, Nuh: 10.
3. Kurani, En-Nisa: 110.
4. Kurani, En-Neml: 46.
5. Xhamiul-Ulum, 344.
6. Kurani, Nuh: 11.
7. Kurani, Nuh: 12.

> "Shtojeni istigfarin sa më shumë sepse me të vjen furnizimi, zgjidhja e problemeve, dija e dobishme, lehtësimi, fshirja e gjynaheve, etj.

5. Istigfari e shton forcën në të gjitha aspektet. Istigfari e forcon njeriun shpirtërisht[8] dhe fizikisht[9]. Allahu i Madhëruar thotë: "Allahu do t'ju shtojë fuqi mbi fuqinë tuaj".[10] Dijetarët si Tahir ibn Ashur[11] dhe Fahrudin Razi[12] në tefsirin e këtij ajeti thonë se populli i Ad-it, në kohën e tyre, dallohej nga popujt e tjerë me bujqësi të begatshme, ndërtesa të larta dhe me pushtet të fortë mbi të tjerët. Kjo shihet qartë në ajetin 15 të sures Fussilet dhe në ajetin 7-8, të sures El-Fexhr. Fuqia, në këtë ajet, përmbledh në domethënien e saj, fuqinë shpirtërore, fizike, mentalitetin, karakterin, pushtetin, pasurinë, fëmijët, etj.

6. Istigfari është shkak për shijimin e kënaqësive në këtë botë. Allahu (xh.sh) thotë: "Ai do t'ju mundësojë të shijoni kënaqësi të bukura deri në afatin e caktuar".[13] Istigfari e ndihmon njeriun në këtë botë për të jetuar një jetë të lumtur, të begatshme dhe të rehatshme.

Prej sunetit të Pejgamberit (a.s) është që kur del nga tualeti të thuash: Gufrāneke. (Kërkoj faljen Tënde, o Zot!).[14] Dikush mund të thotë: Përse e themi këtë fjalë përderisa nuk kemi bërë ndonjë gjynah? Dijetarët kanë thënë: Në tualet nuk bën që të përmendët Allahu. Për shkak të kësaj kohe që ti nuk e ke përmendur Allahun thua: O Zot më fal që nuk të përmenda Ty!

Gjithashtu shohim se i Dërguari i Allahut çdo punë të tij e mbyllte me istigfar. Kur mbaronte namazin thoshte tre herë estagfirullah, kur përfundonte Haxhin bënte istigfar. Gjithashtu edhe mexhliset e tij i mbyllte me istigfar. Kështu që njeriu në çdo çast duhet të ndiejë nevojën e tij për mëshirën dhe faljen e Allahut edhe nëse kryen punë të mira.

Njeriu gjithmonë është mes mirësive të Allahut, që duhet ta falënderojë Atë, por edhe vepron gjynahe që duhet t'i kërkojë falje Allahut. Përderisa askush prej nesh nuk përjashtohet nga kjo gjendje, atëherë istigfari duhet të jetë i pranishëm kudo dhe në çdo çast, jo vetëm për gjynahet por edhe për mangësitë e falënderimit të Allahut dhe për mirësitë e Tij të pafundme ndaj nesh. Kështu që besimtari ka nevojë që në fund të çdo pune të mirë të bëjë istigfar.

7. Istigfari është siguri për besimtarin nga dënimi i Allahut. "Allahu nuk do t'i ndëshkojë ata, përderisa ata i kërkojnë falje Atij".[15] Hasan El-Basriu (rahimehullah) ka thënë: Nuk mendoj se Allahu do ta dënojë një person që kërkon falje tek Allahu. E pyetën: Përse? Tha: Kush ia inspiroi atij kërkimin e faljes? I thanë: Allahu. Hasan el-Basriu tha: E si mund ta inspirojë Allahu kërkimin e faljes e të ketë për qëllim dënimin?!

8. Istigfari është cilësi e besimtarit. Në suren Edh-Dharijat, Allahu na tregon për cilësitë e besimtarëve që do të hyjnë në xhenet dhe një prej cilësive të tyre është istigfari në agim: "Ndërsa në agim ata kërkonin falje (nga Allahu)".[16]

Shtojeni istigfarin sa më shumë sepse me të vjen furnizimi, zgjidhja e problemeve, dija e dobishme, lehtësimi, fshirja e gjynaheve, etj.

8. Shpirtërisht, dmth. aq sa më afër Zotit je, aq sa më shumë i lutesh dhe i kërkon falje Atij, aq më i dashur bëhesh tek Ai. (Aq më të fortë e ke besimin tënd).
9. Fizikisht, d.m.th, njeriu nëse mbështetet dhe lidhet për Allahun, vullneti, entuziazmi dhe qëllimet e tij e bëjnë atë jashtëzakonisht të fuqishëm.
10. Kurani, Hud: 52.
11. "Tefsir Et-Tahrir ve Et-Tenvir", Sureja Hud.
12. "Tefsir El-Kebir ve Miftahul-Gajb", Sureja Hud.
13. Kurani, Hud: 3.
14. Transmetuar nga Tirmidhiu dhe Ebu Davudi.
15. Kurani, El-Enfal: 33.
16. Kurani, Edh-Dharijat: 18.

NË VIJIMËSI TË TRADITËS ISLAME

Këshilltari i Zyrës për Çështjet Fetare, z. Bekir Yanılmaz, pranë Ambasadës së Turqisë në Tiranë, duke shlyer borxhet e personave, të cilët kanë marr ushqime me listë në dyqanet ushqimore të fshatit Drisht.

T.C. Tiran Büyükelçiliği Din Hizmetleri Müşavirliği:

Bugün İşkodra-Drisht köyüne giderek bir Osmanlı geleneği olan yoksul ailelerinin bakkala olan borçlarını ödedik.

Në vijimësi të traditës Islame në kohën e shteti Osman, sot shkuam në fshatin Drisht të qytetit të Shkodrës dhe shlyem veresijet e familjeve të cilat nuk kanë mundësi të paguanin borxhet e ushqimeve të blera në dyqan.

HZ. MUHAMMEDI (A.S), SHEMBULLI I NJË GJYSHI TË PËRKRYER

Besim Barbullushi, *teolog*

Teksa shohim burimet nga historia islame dhe hadithet e Resulit (a.s) ashtu siç ai ka qenë i mëshirshëm, i dashur dhe i butë me fëmijët e tij, njëjtë edhe me nipërit dhe mbesat e tij. Edhe pse një gjysh ai nuk u lodh kurrë në përkujdesjen dhe edukimin e tyre. Nipi dhe mbesa e parë e Pejgamberit (a.s) janë Aliu dhe Umame nga vajza e madhe e tij Zejnebi dhe bashkëshorti i saj Ebu'l-Ass (r.a).

Sipas burimeve të historisë islame, nipi Aliu ka ndërruar jetë që në moshë të vogël, ndërsa Umame do të bëhej në të ardhmen bashkëshortja e Hz. Aliut (r.a).[1]

Brezi, gjenerata e Pejgamberit Muhammed (s.a.s) dhe vazhdimësia e familjes duke parë që fëmijët e tjerë kanë ndërruar jetë të gjithë në moshë të vogël është vetëm nga vajza e tij Fatimja (r.a) dhe bashkëshorti i sajë Hz. Aliu (r.a). Kjo vazhdimësi erdhi nga Hasani dhe Hyseni (r.a). Gjenerata e ardhur nga familja e Hz. Hasanit (r.a) u quajt "sherif", ndërsa gjenerata e ardhur nga Hz. Hysejni (r.a) u quajt "sejid".

Nëse shohim mënyrën se si i Dërguari i Allahut është sjellë me nipërit dhe mbesat, si e ka kaluar kohën me ta, çfarë metodash ka përdorur ai për edukimin e tyre, do të gjejmë një numër të madh burimesh në hadithe të ndryshme të transmetuar. Dashuria dhe përkujdesja që ai ka pasur për ta është një shembull për te gjithë njerëzimin.

Kjo përkujdesje dhe interesim i të Dërguarit ndaj nipërve dhe mbesave fillonte që në momentin kur ata vinin në këtë dynja. Që në momentin e lindjes ai i këndonte ezanin në të dy veshët dhe bënte kurban "akika" për ta.[2] Emrat i zgjidhte me kujdes dhe me kuptim të bukur. Nëse kishte ndonjë fëmijë që në periudhën e xhahilijetit (injorancës) u ishte vendosur ndonjë emër me kuptim jo të përshtatshëm, i Dërguari i Allahut atë ua ndërronte.[3]

Sa herë që me nipërit Hasanin dhe Hysenin takohej iu ledhatonte kokën dhe i përqafonte. Ndërsa mbesën, Umame e ka mbajtur përherë në supe. Kur falte namazin ajo ishte mbi supin e Pejgamberit (a.s). Ndërsa kur ulej në sexhde e vendoste në tokë dhe kur ngrihej e vendoste përsëri në supe.

Gjithashtu nipat e tij kur ai falte namazin i hipnin në supe, në shpinë dhe ai kur ulej në sexhde dhe kur ngrihej në këmbë (kijam) bënte shumë kujdes dhe lëvizte me ngadalë në mënyrë që fëmijët të mos vriteshin. Kur namazi përfundonte, Pejgamberi (a.s) i merrte dhe i ulte tek gjunjët e tij.[4] Kur i Dërguari i Allahut ulej në sexhde dhe nipat e tij i hipnin mbi supe, ai e zgjaste sexhden deri në momentin që ata uleshin.[5]

Kur i Dërguari i Allahut ishte në këmbë (kijam) gjatë namazit, nipat u mundonin të kalonin mes këmbëve të tij dhe ai i lejonte. Ai nuk ishte kurrë kundër, që fëmijët të mos luanin. Këtë gjë e shohim edhe gjatë namazit ku Pejgamberi (a.s) nuk është zemëruar kurrë me ta.[6]

Transmetohet se një ditë kur i Dërguari i Allahut (a.s) po ndante disa hurma zekati, pasi mbaroi punë e morri nipin e tij, Hasanin (r.a) dhe e vendosi mbi supe.[7] Në atë moment afër të Dërguarit (a.s) gjendej sahabia Bera (r.a). Ai tregon, teksa Profeti Muhammed (a.s) po vendoste Hasanin në supe tha kështu: "O Allah me të vërtetë unë e dua Hasanin; duaje edhe Ti."[8] Disa transmetime thonë që ato i ka hipur edhe në deven e tij.[9] Dashurinë dhe përkujdesjen ndajë tyre ai e shfaqte në çdo vend dhe në çdo moment.

Njëri nga sahabët e nderuar transmeton: "Një ditë Pejgamberi (a.s) erdhi tek unë. Në njërin sup kishte Hasanin dhe në tjetrin Hysenin. Gjatë gjithë rrugës, një herë përqafonte njërin dhe një herë tjetrin".[10]

Një transmetim tjetër që tregon për dashurinë dhe përkujdesin, që kishte i Dërguari për nipat dhe mbesat nga Ebu Hurejra: "Një ditë bashkë me Pejgamberin (a.s) shkuam te shtëpia e Fatimes (r.a). Sapo mbërritëm ai pyeti: "Ku është ai burri vogël, ku është ai burri vogël?" (e kishte fjalën për Hasanin (r.a). Kur Hasani erdhi, e përqafoi dhe më pas tha këto fjalë; "O Allah, unë e dua shumë Hasanin, të lutem Ty, që Ti ta duash atë dhe të gjithë ata që e duan atë".[11]

Një hadith të ngjashëm e transmeton edhe sahabiu Usame b. Zejd ku thotë: "Profeti (a.s) kur përqafonte Hasanin dhe Hysenin iu drejtonte Allahut me lutjen: "O Allahu im, un i dua këta dhe shpresoj që t'i duash edhe Ti".[12]

Këtë mëshirë dhe dashuri për fëmijët, i Dërguari i Allahut e ka treguar në çdo situatë. Një ditë atë e thirrën në shtëpinë e një sahabiu dhe gjatë rrugës ai pa Hysenin tek sa po luante me fëmijët e tjerë dhe në atë moment Pejgamberi (a.s) përkulet, hap krahët dhe e përqafon nipin e tij.[13]

Ndërsa një ditë tjetër, i Dërguari i Allahut po mbante hytben e xhumasë dhe sheh nipat e tij, Hasanin dhe Hysenin që po ecnin drejt tij, ashtu me zor si fëmijë që ishin, herë herë edhe duke u rrëzuar. Profeti ynë i dashur zbriti nga minberi, i morri nipat në krahë dhe tha: "Allahu jua ka bere shkak sprove pasurinë dhe fëmijët (pasardhësit).[14]

Pasi u ngjit edhe një herë në minber tha: "Nuk munda t'i lija ashtu duke ecur dhe rrëzuar fëmijët e mi, andaj zbrita poshtë dhe i morra lart."[15]

Gjithë këto shembuj tregojnë këtë lidhje të veçantë të Pejgamberit (a.s) me nipërit e tij. Ai kishte një lidhje shumë të veçantë me Hasanin dhe Hysenin. Transmeton Enes ibn Malik (r.a), se është pyetur Resulallahu (s.a.v): "O i Dërguari i Allahut, kë do më shumë nga Ehli Bejti" dhe ai është përgjigjur: "Hasanin dhe Hysenin". Ndërsa në një hadith tjetër Pejgamberi (a.s) thotë: "Hyseni është i imi dhe unë jam i Hysenit. Allahu e do atë që do Hysenin.[16]

1. İbn Sa'd, Et-Tabakat, VIII, 31.
2. Ebu Davud, Edeb, 114.
3. Imam Ahmedi, Musned, I, 98, 118.
4. Imam Ahmedi, Musned, II, 513.
5. Imam Ahmedi, Musned, III, 494; Nesai, Tatbik, 82.
6. Buhari, Fedailu's-Sahabe, 22, İlim, 18, Salat, 106;
7. Imam Ahmedi, Musned, II, 279.
8. Buhari, Fedailu'l-Ashab, 22.
9. İbnu'l-Esir, Usdu'l-Gabe, IV, 126.
10. Imam Ahmedi, Musned, II, 440.
11. Buhari, Menakib, 27; Muslim, Fedail, 17.
12. Buhari, Menakib, 27; Tirmidhi, Menakıb, 31.
13. İbn Maxhe, Mukaddime, 11.
14. Kur'ani, El-Enfal:28.
15. Tirmidhiu, Menakıb, 31.
16. Buhari, Fedail, 18-22; Muslim, Fedail, 32, 56, 58-61, 67;

KONFERENCA E STUDENTEVE NGA DURRËSI, NË ATMOSFERËN E MUAJIT TË MEVLUDIT SHERIFË

Pasditen e së shtunës, më 9 tetor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në konferencën e organizuar nga Medreseja e Durrësit, me studente të përzgjedhura ndër vite, që kanë ardhur për vizitë në Shkodër.

Pas fjalës së drejtorit të Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, Myftiu i Shkodrës ligjëroi mbi shembullin e Resulullahut (a.s) në edukimin e elitave, për të cilat ka nevojë çdo shoqëri.

Myftiu tha se vajzat e reja muslimane nuk duhet të ndjehen të kompleksuara në shoqëri për shkak të hixhabit, përkundrazi ato duhet të ndjekin rrugët e dijes në të gjitha fushat, duke e lexuar si duhet fenë dhe udhëzimin hyjnor që thërret drejt dëshmimit tonë si prijës të elitave, por a jemi ne sot, muslimanë të këtij niveli kuranor?

I ftuar special në këtë konferencë ishte edhe Dr. Salahudin Keftaro, që po qëndron prej disa ditësh në Shkodër, me ftesë të Myftiut Sytari.

Në fjalën e tij, Dr. Keftaro tha se në Islam janë zgjidhur dilemat dhe janë saktësuar të drejtat dhe përgjegjësitë, sikurse ka dëshmuar vlerësimin e gruas në të gjitha etapat e jetës së saj.

Zotëria e tij solli disa shembuj të mrekullueshëm nga udhëtimet dhe përvojat e tij gjatë udhëtimeve në shtete e vende të ndryshme, sikurse u lut për më të mirën për vajzat tona.

Konferenca vijoi me pyetje-përgjigje me dobi për të pranishmit.

DR. SALAHUDIN KEFTARO: "MISIONI YNË ËSHTË MËSHIRA DHE HAPJA ME TJETRIN!"

Paraditën e së mërkurës, më 13 tetor 2021, në kuadër të aktiviteteve në përkujtim të Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s.), Myftinia Shkodër organizoi një trajnim me imamët e saj, ku i ftuar i veçantë ishte mendimtari i shquar islam sirian, Dr. Salahudin Keftaro.

Në fjalën e tij para të pranishëmve, Dr. Keftaro u ndal te rëndësia e rileximit të fesë dhe teksteve të saj, me qëllim pastrimin nga pluhuri i keqleximit dhe keqinterpretimit, si dhe përhapjen e dritës së teksteve tona në mesin tonë dhe para botës mbarë.

Dr. Keftaro theksoi se bashkëpunimi në mesin e muslimanëve, është kushti i parë i rimëkëmbjes, duke bërë çmos distancimin nga emërtimet dhe cilësimet përçarëse, sepse thirrja e Kur'anit është që të jetojmë e të punojmë si vëllezër.

Ai theksoi se ne si muslimanë nuk e kthejmë të keqen me të keqe, jo nga dobësia, porse misioni ynë në jetë është mëshira dhe hapja me tjetrin deri në kufijtë e lutjes!

Në fjalën e tij, Dr. Salahudin Keftaro theksoi se Islami është çështje e triumfuese, porse ka nevpjë për përkrahës të aftë dhe thirrës largpamës e të urtë!

Njëkohësisht bëri thirrje që të punojmë me sinqeritet në rrugën e realizimit të hartës kur'anore, që nxit drejt mësimit të Librit, urtësisë dhe edukimit.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, që vlerësoi mikun e shtrenjtë për vizitën dhe praninë në mesin e imamëve të Shkodrës, sikurse bëri një përmbledhje të fjalës së Dr. Salahudin Keftaro, duke u lutur për mbarësi e suksese për imamët që shërbejnë me përkushtim e urtësi në rrugën e Thirrjes Islame.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga z. Kujtim Dervishi, drejtor i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", si dhe u bënë pyetje me dobi për pjesëmarrësit.

VIJON CIKLI I AKTIVITETEVE “MËSOJMË DHE ARGËTOHEMI”

Ditën e diel, më 17 tetor 2021, në zonën turistike të Reçit, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër zhvilloi aktivitetin e radhës të ciklit “Mësojmë dhe argëtohemi”, me pjesëmarrjen e rreth 20-30 nxënësve të kursit fetar/mejtepit të xhamisë Zues, nën shoqërimin e mësuesve Ritvan Luzaku dhe Kimete Elezi.

Në këtë aktivitet ishte i pranishëm edhe teologu Arben Halluni, drejtuesi i arsimit, i cili pasi i uroi mirëseardhjen nxënësve në këtë veprimtari arsimore-argëtuese të radhës u mbajti një bisedë të shkurtër me vlera edukative dhe me këshilla mjaft të dobishme për ta.

Më pas, programi vijoi me zhvillimin e një konkursi, biseda brenda grupeve, lojëra të ndryshme sportive, shëtitje në natyrë etj.

Cikli i aktiviteteve “Mësojmë dhe argëtohemi”, do të vijojë me të tjera xhami gjatë periudhës vjeshtë-dimër.

MYFTIU: “A JE GATI TË MARRËSH NJË ZOTIM PARA RESULULLAHUT?”

Paraditën e së enjtes, më 21 tetor 2021, në kuadër të aktiviteteve me rastin e përkujtimit të Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s), Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim të përzemërt me maturantët e Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”.

Fillimisht, Myftiu falënderoi drejtorin e shkollës, z. Kujtim Dervishi, përgjegjësin e lëndëve fetare, z. Gezim Dungaj, mësuesin Evans Drishti dhe përfaqësuesit e Myftinisë, të pranishëm në këtë takim.

Gjatë ligjëratës së tij, Myftiu kërkoi nga maturantët që të shfrytëzojnë kohën, të përsosin adhurimin, të ndjekin thirrjen drejt së cilës janë ftuar në jetë dhe ta përsosin atë me sa të kenë mundësi, të jenë shembull në moral dhe mirësjellje, të synojnë përherë më të lartën në jetë, të jenë falënderues e mirënjohës dhe të dëshmohen njerëz me dinjitet dhe integritet, në gjurmët e bashkëmoshatarëve të tyre, që u bënë yje ndriçues në gjurmët e Hz. Muhammedit (a.s)!

Myftiu solli në vëmendje të maturantëve shembullin e një adoleshenti në marrëdhënie me Pejgamberin (a.s) dhe kërkoi që secili prej tyre të ketë një komunikim të brendshëm me të dërguarin e Zotit, për t’u zotuar përpara tij për ecurinë drejt suksesit në jetë.

Ky takim u plotësua edhe me këshillat e urta të drejtorit të Medresesë dhe mësuesve të nderuar të pranishëm, sikurse u shoqërua edhe me pyetjet interesante të djemve drejtuar Myftiut.

TAKIM VLERASH ME STUDIUESIN E SHQUAR XHEMAL BALLA

Paraditën e së shtunës, më 23 tetor 2021, në kuadër të ciklit të trajnimeve që organizon Myftinia Shkodër me imamët e saj, u zhvillua edhe takimi i 9-të, ku i ftuar ishte studiuesi i shquar nga Tirana, prof. Xhemal Balla.

Në krye të herës, teologu Lavdrim Hamja theksoi se i ftuari i sotëm është një ndër emrat më të spikatur të këtyre 30 viteve, që ka dhënë një kontribut të madh për bashkësinë muslimane shqiptare, nëpërmjet drejtimit në arsim dhe botimeve të shumta e plot dobi.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, pasi falënderoi prof. Xhemal Ballën për përgjigjen e ftesës, tha se prania e zotërisë së tij në mesin e imamëve shkodranë është pa dyshim edhe një mundësi më shumë për të përfituar nga dija dhe përvoja e gjatë e studiuesit të shquar të veprave të hoxhallarëve të shkuar të vendit, si dhe një simbolikë e lidhjes me brezin e shkuar dhe gjurmët e tyre.

Ndërkohë, në fjalën e tij para të pranishmëve, prof. Xhemal Balla theksoi se 87 vitet që mban mbi supe e lidhin përherë e më shumë e kohën e hoxhallarëve të shquar shqiptarë, ku veçohet Hafiz Ibrahim Dalliu, shkollës së të cilit edhe i përket.

Ai hodhi dritë mbi jetën dhe veprën e Hafiz Dalliut, sikurse theksoi se kolana prej 10 vëllimesh me titull: “Njeriu dhe Kurani”, është pjesë e punës së palodhur disavjeçare të studiuesit Balla, për të nxjerrë në pah vështrimet e Hafiz Dalliut në rrobë bashkëkohore.

Një fjalë përshëndetëse mbajti edhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, sikurse u zhvillua edhe një bashkëbisedim me të ftuarin, rreth aktivitetit dhe nxitjes së thirrësve islamë drejt punës shkencore.

MYFTIU PRITI DELEGACIONIN E XHAMISË “DITURIA” NGA GJENEVA

Pasditen e së shtunës, më 23 tetor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, të nderuarin H. Rijad Aliu, imam i xhamisë shqiptare “Dituria” në Gjenevë të Zvicrës, së bashku me pjestarët e nderuar të delegacionit.

Gjatë takimit të përzemërt, bashkëbiseduesit u fokusuan tek kontributi i shquar i imamëve dhe hoxhallarëve shqiptarë për përhapjes e dritës së udhëzimit islam kudo nëpër botë dhe veçanërisht në Zvicër.

U ndanë mendime rreth fushës së botimeve, me ç’rast, H. Rijad Aliu i dhuroi Myftiut, edhe në emër të Qendrës Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion në Lozanë dhe kryetarit të saj të nderuar, Mr. Fehim Abazi, veprën e titulluar: “Enciklopedia e hadithеve kudsij”, botimi më i ri i kësaj qendre, përkthyer në shqip nga studiuesi mirënjohur, Dr. Bashkim Aliu.

Me rastin e kësaj vizite të shtrenjtë, Myftiu shtroi një darkë vëllazërore.

MEVLUDI SHERIFË DHE VLERA E TIJ NË FOKUS TË EMISIONIT "TONIGHT" NË STAR PLUS TV

Iftuar i radhës i emisionit "Tonight" në Star Plus Tv ka qenë Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili ka folur në lidhje me simbolikën e kësaj ngjarjeje për të gjithë besimtarët myslimanë.

Myftiu tha që periudha e Mevludit është një periudhë shumë e begatë për myslimanët në botë: "Për myslimanët dhe bashkësitë islame kudo qofshin në botë, natyrshëm se lindja e Pejgamberit tonë (a.s), është një ngazëllim dhe një gëzim i madh për të gjithë botët, sepse ai është dërguar mëshirë për të gjitha botët, çka do të thotë se përtej faktit nëse u gëzuan apo nuk gëzuan, e njohën apo nuk e njohën, qenë të vëmendshëm apo neglizhentë njerëzit, nga myslimanët apo jomyslimanët në këtë ngjarje të madhe, them me plot bindje se vendet e botës gëzohen në këtë ditë, në këtë muaj dhe në këtë atmosferë të lindjes së Profetit tonë të dashur, Muhamed (a.s)".

Në vijim, Myftiu tha: "Që të gjitha institucionet islame kudo në botë përgatiten dhe organizojnë aktivitete të ndryshme me qëllim që njerëzit të njoftohen për jetën dhe veprën e ndritur të Dërguarit të Zotit, Hz. Muhammedit, i cili ishte hallka e fundit e zinxhirit të profetëve të mëparshëm dhe që njihet dhe përmendet në librat origjinal hyjnorë, përtej Kuranit Famëlartë".

Një pjesë e rëndësishme e kësaj bisede nën drejtimin e gazetarit të njohur, Erzen Koperaj ka qenë edhe ruatja e traditës së Mevludit Sherifë, e cila çdo vit kujtohet përmes aktiviteteve të ndryshme në xhami, përmes seminareve, takimeve me të rinjtë, etj.

Sipas, Myftiut këndimi i Mevludit është një traditë kombëtare: "është pjesë e një traditë shumëshekullore e myslimanëve, e cila bazohet në urdhëresat kuranore dhe në traditën profetike dhe në shembullin e sahabëve të Pejgamberit (a.s) që i kanë kënduar në prani të tij dhe Resulullahu është kënaqur dhe gëzuar, duke i thurur vargje, duke i kënduar dashnisë së tij. Prandaj ruajtja e përkujtimit të Mevludit Sherifë është një obligim fetar dhe moral, por mbi të gjitha një obligim kombëtar".

Myftiu, Imam Muhamed B. Sytari dha edhe disa mesazhe dhe këshilla të vyera për teleshikuesit dhe për të gjithë besimtarët që të jenë të bashkuar njeri me tjetrin, të punojnë me sa të kenë nundësi për të jetuar me dinjitet, të nderojnë dhe të respektojnë tjetrin, mbi bazat e udhëzimit hyjnor.

MYFTIU UROI DREJTORIN E RI TË POLICISË SHKODËR

Paraditën e së enjtes, më 28 tetor 2021, Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë zyrtare në Policinë Vendore të Shkodrës, për të uruar drejtorin e ri të saj, z. Hamdi Fjora.

Gjatë takimit, Myftiu i uroi drejtorit Fjora mbarësi dhe suksese në shërbimet e tij, duke theksuar se bashkëpunimi i institucioneve për ruajtjen e sigurisë, paqes sociale dhe harmonisë në vendin tonë është obligim kombëtar dhe moral.

Myftiu dhe drejtori i Policisë ndanë mendime rreth fushave të bashkëpunimit, sikurse trajtuan edhe disa prej sfidave me të cilat përballet sot shoqëria shqiptare, rinia në veçanti, si dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit për të mirën e përbashkët.

Drejtori i Policisë Vendore Shkodër, e falënderoi Myftiun dhe theksoi se roli i komuniteteve fetare është i madh në edukimin e masave me frymën e harmonisë dhe bashkëjetesës, ruajtjes së traditave kombëtare dhe tabanit.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu i dhuroi drejtorit të ri të Policisë Shkodër disa prej botimeve të tij.

MYFTIU: "FAMILJA E SOTME TË KTHEHET NGA DRITA E RESULULLAHUT!"

Ditën e shtunë, më 30 tetor 2021, në xhaminë e fshatit Trush u zhvillua ceremonia tradicionale e Mevludit Sherifë, në kuadër të aktiviteteve të larmishme në përkujtim të Lindjes së Begatë të Resulullahut (a.s) dhe mesazhit me të cilin u dërgua si mëshirë për mbarë botët.

Aktiviteti nisi me leximin e një pjese kuranore nga H. Ervis Molla, imam i xhamisë Barbullush.

modele që na vijnë nga jashtë besimit e fesë dhe traditave tona shekullore.

Ai dha disa shembuj nga shembulli dhe karakteri i Hz. Muhamedit (a.s), duke ftuar besimtarët të ecin në këtë shembull me të gjitha mundësitë e forcën e tyre.

Aktiviteti vijoi me këndimin e disa pjesëve nga "Mevludi" i H. Ali Riza Ulqinakut, nga imamët e nderuar Astrit Nikaj, që nderoi me pjesëmarrjen e tij nga Ana e Malit (Mali i Zi), Bujar Hoxhani

Më pas, ligjëroi Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, i cili u përqendrua tek domosdoshmëria e njohjes së Resulullahut (a.s) dhe angazhimi për ta ndërtuar jetën mbi bazat e mesazheve dhe traditave të tij, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në mesin e njerëzve, sidomos në familje.

Myftiu tha se familja e sotme shqiptare ka probleme në rritje, që kërkon më shumë angazhim për t'u kthyer nga tabani ynë fetar e ai kombëtar, për ta ruajtur familjen dhe për të mos pranuar (imam i xhamisë Kosmaç), H. Ervis Molla dhe i nderuar Elsamet Tula.

Në fund, imami i xhamisë Trush, H. Jetmir Braqi, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe theksoi se ky tubim tradicional është dëshmi e përkushtimit dhe dashnisë për të dërguarin e Allahut dhe fenë e Tij.

Nën drejtimin e Myftiut u krye edhe falja e namazit të mesditës me xhemat dhe pas lutjes, të pranishmit këmbyen urimet e tyre për këtë gëzim të madh.

Pasi u shfaq pranë Erdoganit në takimin me Biden, përkthyesja e Erdoganit, tërheq përsëri vëmendjen...

Kush është ajo?

Fatime Kavukxhi Ebu Sheneb me origjinë palestineze.

E specializuar në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në marrëdhëniet mes myslimanëve dhe të krishterëve.

Ka punuar si ndihmëse hulumtuese në Shtetet e Bashkuara në disa institucione, nga ato edhe në Kongres.

E bija e Merva Kavukxhi, e para deputete me hixhab në parlamentin turk, e cila u dëbua dhe iu hoq nënshtetësia e saj nga Sulejman Demirel, president i Turqisë në atë kohë, për shkak të hixhabit të saj.

Merva emigroi në Shtetet e Bashkuara, përpara se të kthehet përsëri në Turqi dhe gjithashtu t'i rikthehet edhe një herë nënshtetësia turke!

Shejkh Ahmed Keftaro - (1915 - 2004)

“Sikur MUHAMMEDI, i biri i Abdullahut, TË ISHTE NJERI I THJESHTË, e jo udhërrëfyes, i dërguar dhe profet, a do të kishin arritur arabët tërë atë qytetërim dhe krenari, prestigj dhe shtet, siç kanë regjistruar librat e kohës dhe të historisë për arabët!?”

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek